



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

KËSHILLI BASHKIAK
Komisoni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit
dhe të Drejtave të Njeriut

Nr 1179/Prot.

Fushë-Arrëz, më 25. 04. 2025



RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 11, datë 18/04/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me Projekt vendimin "Mbi fondin e kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% Mars 2025"

Analiza ligjore: Në mbështetje të ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019. "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu IV, pika 2 të Vendimit Nr.955, datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" të ndryshuar, Vendim Nr.5, datë 23.02.2018 "Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, me përjashtim të pikës 1,6,7, që do të trajtohen me ndihmën ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike.

Situata aktuale e funksionit: Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për uljen e varfërisë. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për kujdesin social.

Situata financiare : Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Mars 2025, për 31 familje, me 120,808 lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Çështjeve Sociale ka relatuar përpara komisionit për Projekt Vendimin

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Çështjeve Sociale për zbatimin e projektit.

Impakti social / grupet që preken: Impakton jetën të gjitha shtresave të varfra në të gjithë territorin të bashkisë

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt konsultimi publik

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut, i mbledhur me datën 25/04/2025, shqyrtoi projektvendimin nr.11 datë 18/04/2025, relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me projektvendimin “Mbi fondin e kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% Mars 2025” paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,


VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në Relacionin e mbledhjes së Komisionit

Franc Doda  Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Pavlin Qafa  Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)